



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 234, Datë 30.09.2025

MBI

**DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN E BORDIT TË ERE-S NR. 191, DATË 21.07.2022,
“MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË “KORÇA PHOTOVOLTAIC PARK” SH.P.K., NË
VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA CENTRALI
FOTOVOLTAIK, ME VENDNDODHJE NË ZONËN BITINCKË, BILISHT, QARKU
KORÇË, ME KAPACITET TË INSTALUAR 2 MW”**

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; nenit 113 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”; si dhe nenit 15 të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.06.2016, Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 30.09.2025, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 2524 prot., datë 30.09.2025, të Drejtorisë së Politikave të Burimeve të Rinovueshme, “Mbi disa ndryshime në vendimmarrjet e bordit të ERE-s lidhur me plotësimin e kushteve nga subjektet e licencuar në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike.”,

Konstatoi se:

1. Të dhëna mbi shoqërinë “KORÇA PHOTOVOLTAIC PARK” sh.p.k.

- Me vendimin nr. 191, datë 21.07.2022, Bordi i ERE-s ka licencuar shoqërinë “KORÇA PHOTOVOLTAIC PARK” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik, me vendndodhje në zonën Bitinckë, Bilisht, qarku Korçë, me kapacitet të instaluar 2 MW, për një afat 25-vjeçar.
- Në vendimin nr. 191/2022, janë përcaktuar ndër të tjera: 2: Shoqëria duhej të depozitonte në ERE informacion mbi saktësimin e gabimeve të mundshme në lidhje me referimin që i bëhet kontratave të qirasë me Bashkinë Devoll. 3: Shoqëria duhej të përcillte në ERE kontratat e qirasë të rinovuara (jo më vonë se datat 11.09.2038 dhe 22.11.2038) ose dokumente të tjera ekuivalente që rregullojnë pronësinë. 4: Ky vendim është objekt rishikimi nga ERE.

2. Analiza Ligjore dhe Vlerësimi

- Pas ndryshimeve të miratuara me vendimin e bordit të ERE nr. 220, datë 01.09.2022, në Rregulloren “Për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.06.2016, është riformatuar neni 9 i rregullores “Formati dhe dokumentacioni për aplikim”, duke shfuqizuar gërmën “g” të pikës 2 të këtij neni, e cila përcaktonte se në dokumentacionin juridik, administrativ dhe pronësor të paraqitur për aplikim përfshihen dhe dokumentet që vërtetojnë pronësinë e aplikuesit në zonat ku do të shtrihet projekti (kontrata shitblerje, kontrata qiramarrje, akte dhurimi, kontrata premtim

shitblerje, marrëveshje me subjekte që kanë në pronësi zonat ku shtrihet projekti për ato veprimtari që përdorin asete për kryerjen e aktivitetit të licencuar).

- Në këto kushte, detyrimet e përcaktuara në pikat 2 dhe 3 të vendimit nr. 191/2022 nuk gjejnë më mbështetje rregullatore.
- Duke qenë se pika 4 lidhet drejtpërdrejt me objektin e pikave 2 dhe 3, ajo humbet qëllimin e saj dhe duhet të shfuqizohet.
- Në përputhje me nenin 113 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, shfuqizimi i pikave 2, 3 dhe 4 është i domosdoshëm për të harmonizuar vendimin me kuadrin ligjor dhe për të siguruar qartësi dhe koherencë në kushtet e licencës së shoqërisë.

3. Nevoja për Ndryshimin e Vendimit

- Ndryshimi është i nevojshëm për të shmangur pasiguritë ligjore dhe për të siguruar koherencë të vendimit me kuadrin rregullator aktual.
- Shfuqizimi i pikave 2, 3 dhe 4 është i nevojshëm për të shmangur pasiguritë ligjore dhe për të reflektuar kuadrin rregullator të përditësuar.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Pikat 2, 3 dhe 4 të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 191, datë 21.07.2022, shfuqizohen.
2. Heqja e kushteve nuk përjashton këtë shoqëri nga detyrimi për të ruajtur në vazhdimësi të drejtën e ligjshme të përdorimit të territorit ku shtrihet veprimtaria e licencuar, në përputhje me kontratat përkatëse ose aktet e pronësisë.
3. Drejtoria e Politikave të Burimeve të Rinovueshme, të njoftojë shoqërinë “KORÇA PHOTOVOLTAIC PARK” sh.p.k., Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, FTL sh.a. dhe OSSH sh.a. lidhur me vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes dijeni, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Petrit AHMETI